



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1115/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e Genc Shurdhaj, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, paraqitur kundër Raportit të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për kandidatët që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 27.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli i parashtruar nga Genc Shurdhaj, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, paraqitur kundër Raportit të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për kandidatët që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së të datës 23.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 24.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Genc Shurdhaj, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, me të cilën ka kërkuar që të bëhet verifikimi i votave të tij, pasi që sipas tij kur janë shpallur rezultatet ai ka pasur 288 vota, ndërsa tani pas rinumërimit pa ndonjë arsye atij i janë publikuar 287 vota.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmëris së ankesës, gjeti se:

apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Genc Shurdhaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Nisma është i palejuar. Sepse KQZ ka shpallur Raportin e kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, ku nga ky rinumërim kandidati Genc Shurdhaj nuk ka dal fitues pasi që

pas rinumërimit është konstatuar se ai posedon gjithsej 287 vota, që do të thotë më pak se kandidati tjetër i cili ka fituar mandatin.

Me dispozitën e nenit 106.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i cili përcakton se: “KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa”. Për më tepër nuk e përcakton asnjë dispozitë ligjore të parashtrohet ankesë ndaj rezultatit që rezulton pas rinumërimit me vendimin e PZAP-it.

Prandaj, nga këto arsye arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1115/2017 me datën 27.11.2017.



Kryesuesi i Panelit

Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.